Numër: 02-352
Datë: 08.10.2026

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060, për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ për Njohjen e Mësimit Paraprak (UA Nr. 31/2014, data 05.09.2014), dhe Udhëzimit Administrativ për Kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve që zbatojnë njohjen e mësimit paraprak në Kosovë (UA Nr.09/2019, data 18.06.2019), Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur më datë 07.10.2026 nxjerrë këtë:

VENDIM

1. Akreditohet Qendra e Aftësimit Profesional (QAP) – Prizren, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, nga data 26.03.2026 deri më 25.03.2029, për zbatimin e Njohjes së Mësimit Paraprak (NjMP) në kuadër të kualifikimeve të aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

1.1. "Grimer" – Niveli IV, gjithsej 15 kredi sipas KKK-së. QAP Prizren akreditohet për zbatimin e procesit të Njohjes së Mësimit Paraprak në kuadër të këtij kualifikimi, në përputhje me politikat, procedurat dhe kërkesat e përcaktuara për NjMP-në, si dhe me kapacitetet institucionale, profesionale dhe materiale të verifikuara gjatë procesit të vlerësimit. Institucioni disponon me stafin, hapësirat, pajisjet dhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e procesit të informimit, mentorimit, vlerësimit dhe certifikimit të kandidatëve.

1.2. "Instalues Elektrik" – Niveli III, gjithsej 15 kredi sipas KKK-së. QAP Prizren akreditohet për zbatimin e procesit të Njohjes së Mësimit Paraprak në kuadër të këtij kualifikimi, në përputhje me politikat, procedurat dhe kërkesat e përcaktuara për NjMP-në, si dhe me kapacitetet institucionale, profesionale dhe materiale të verifikuara gjatë procesit të vlerësimit. Ekipi i ekspertëve ka vlerësuar se kapacitetet aktuale të institucionit mundësojnë realizimin e NjMP-së deri në 7 kandidatë në muaj, respektivisht 84 kandidatë në vit.

2. QAP Prizren obligohet që gjatë periudhës së akreditimit t'i përmbushë rekomandimet e ekipit të ekspertëve, veçanërisht përditësimin e dokumentacionit dhe procedurave të NjMP-së, zhvillimin profesional të stafit, forcimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë, përmirësimin e kushteve dhe masave të sigurisë në hapësirat praktike, si dhe forcimin e bashkëpunimit me bizneset për realizimin e vlerësimit praktik.

3. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Në bazë të kërkesës së Qendrës së Aftësimit Profesional – Prizren për akreditim për zbatimin e NjMP-së në kuadër të kualifikimeve "Grimer", Niveli IV, 15 kredi dhe "Instalues Elektrik", Niveli III, 15 kredi sipas KKK-së, si dhe rekomandimit të ekipit të ekspertëve, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ekipi vlerësues ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur nga QAP Prizren dhe ka realizuar vizitën vlerësuese në institucion. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe verifikimi në institucion rezulton se QAP Prizren ka krijuar bazë të mjaftueshme institucionale, profesionale, materiale dhe procedurale për zbatimin e NjMP-së në kuadër të të dyja kualifikimeve.

Për kualifikimin "Grimer", ekipi i ekspertëve ka vlerësuar se institucioni disponon me kapacitetet e nevojshme profesionale, hapësirat, pajisjet dhe dokumentacionin për organizimin dhe zbatimin e procesit të NjMP-së.

Për kualifikimin "Instalues Elektrik", Niveli III, ekipi i ekspertëve ka vlerësuar se kapacitetet aktuale të institucionit mundësojnë realizimin e NjMP-së deri në 7 kandidatë në muaj, respektivisht 84 kandidatë në vit. Janë verifikuar laboratorët, pajisjet dhe stafi i angazhuar për realizimin e vlerësimit praktik.

Institucioni ka paraqitur dokumentacionin për informimin, identifikimin dhe regjistrimin e kandidatëve, portofolion, mentorimin, vlerësimin, certifikimin, ankimimin, sigurimin e cilësisë, mbrojtjen e të dhënave personale dhe monitorimin e procesit.

Ekipi i ekspertëve ka rekomanduar përditësimin e vazhdueshëm të dokumentacionit të NjMP-së, zhvillimin profesional të stafit, forcimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë, përmirësimin e sigurisë dhe pajisjeve në hapësirat praktike, si dhe forcimin e bashkëpunimit me bizneset për realizimin e vlerësimit në mjedise reale pune.

Në bazë të gjetjeve dhe rekomandimit pozitiv të ekipit të ekspertëve, Këshilli Drejtues i AKK-së vlerëson se QAP Prizren i plotëson kushtet për akreditim për zbatimin e NjMP-së në kuadër të kualifikimeve "Grimer", Niveli IV dhe "Instalues Elektrik", Niveli III sipas KKK-së, me obligim që rekomandimet e evidentuara të adresohen gjatë periudhës së akreditimit.

Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues i AKK-së, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK-së, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Qendrës së Aftësimit Profesional – Prizren;
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD-së së AKK-së